V E N D I M
Nr.128, datë 6.3.1995

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.511, DATË 26.10.1993 "MBI NDRYSHIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES BRENDA VENDIT TË DISA LËNDËVE TË PARA, MATERIALEVE, PJESËVE TË NDËRRIMIT, MAKINERIVE ETJ., TË ARDHURA NË KUADRIN E NDIHMAVE DHE KREDIVE ME KUSHTE FAVORIZUESE NGA INSTITUCIONE NDËRKOMBËTARE E SHTETE TË VEÇANTA, SI DHE PËR MËNYRËN E PAGESËS SË TYRE

Me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.511, datë 26.10.1993 bëhen këto ndryshime:

1. Në kreun I, në pikën 2, në fund të paragrafit të dytë, pas fjalëve "organizojmë sipas rregullave në fuqi ankande të hapura për realizimin e shitjeve të tyre", shtohet fjalia "Çmimet dysheme i propozojnë ndërmarrjet dhe i miratojnë ministritë përkatëse nga të cilat ato varen".

2. Në kreun II, pika 2, në paragrafin e dytë, pas fjalës "përdoruesit" shtohen fjalët "(shtetërore apo private)", dhe pas fjalës "ministrive" shtohen fjalët "sipas kritereve që garantojnë shlyerjen e vleftës së kredisë".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi